



Cendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim

# AVOKUESI



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

Perkrah  
komunitetin e OJQ-ve



Vëllimi IV • Numri 9 • Nëntor 2006

## PËRMBAJTJA

### Faqe 2

Rregulloret e tanishme për TVSH dhe taksat doganore pengojnë ndihmat humanitare në Kosovë, thonë OJQ-të

"Të bëjmë qytete më të mira së bashku"

### Faqe 3

SEKTOR Programi i REC-it përkrah organizatat e shoqërisë civile për ambient në Evropën Juglindore

Iniciativa Kosovare për Stabilitet hulumton të kaluarën e Prishtinës, perspektivat për të ardhmen

Agjencioni Antikorrupsion të parandaloj përhapjen e korrupsionit në Kosovë

Të rinj nga Kosova dhe Serbia diskutojnë për të ardhmen

### Faqe 4

"Ne dhe Trupi Ynë - në Shekullin e ri"  
Një libër i shkruar nga gratë për gratë

Avokimi për të Drejtat e Minoriteteve në BE:  
Një udhëzues për OJQ-të në Evropën Juglindore

Shoqëria civile dhe qeverisja e mirë në shoqëritë në tranzicion

**Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj**

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së:  
[www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

## Mundësi financimi për OJQ-të

### IREX dhe ATRC shpallën vitin e dytë të Programit Kosovar të Granteve për Shoqërinë Civile

Përfaqësues të IREX-it dhe ATRC-së më 17 tetor zhvilluan takim informativ me OJQ-të vendore për të prezantuar vitin e dytë të Programit Kosovare të Granteve për Shoqërinë Civile, financiar nga USAID.

IREX dhe ATRC informuan përfaqësuesit e OJQ-ve për programin e sivjem, llojet e granteve në dispozicion për OJQ-të kosovare, procedurat e aplikimit, kriteret e se-

leksionimit, procesin shqyrtues dhe afatin për aplikim për rundin e tretë të granteve për Partneritet dhe Krijim të Rrjeteve.

Grantet e Programit Kosovar për Shoqërinë Civile (KCSP) ndahen në tri kategori: Grantet për Partneritet dhe Krijim të Rrjeteve; Grantet për Përkrahje në Nivel Lokal; dhe Grantet për Fushatë Avokimi në Nivel Qendror.

*Për informata të hollësishme*

*dhe të përditësuara lidhur me programin e granteve të KCSP-së vizitoni [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org).*

Qëllimi i KCSP-së është zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë civile në Kosovë dhe komunitetit të OJQ-ve për të funksionuar si sektor i efektshëm dhe i suksesshëm duke luajtur rol të rëndësishëm në përfaqësimin e gjithë popullsisë kosovare dhe në formulimin e politikave publike.

## Njoftim nga RrRK

### Rrjeti Rinor i Kosovës kërkon rihapjen e zyrave nga autoritetet

Rrjeti Rinor i Kosovës (RrRK) kërkon nga autoritetet të rihapin zyret e këtij rrjeti në Qendrën Rinore në Prishtinë, e cila është mbyllur më 20 tetor nga menaxhmenti i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

"Menaxhmenti i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë ka mbyllur zyret e RrRK-së në mënyrë arbitrare pa paralajmërim", thuhet në njoftimin e RrRK-së të publikuar më 26 tetor.

Sipas RrRK-së, ky akt tregon për mungesën e përkushtimit të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare për të përkrahur të rinjtë në Kosovë.

Rrjeti Rinor i është drejt-



Menaxhmenti i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë ka mbyllur zyret e RrRK-së më 20 tetor

tuar institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare në përpjekje për të rihapur zyret e veta. Rrjeti po tenton ti kryej aktivitetet brenda mundësive që ka, me gjithë gjendjen e krijuar.

RrRK u bën thirrje organizatave rinore në Kosovë që ti përcjellin me vëmendje

këto zhvillime dhe të kenë parasysh përdorimin e mekanizmave të ndryshëm demokratik me anë të të cilëve të rinjtë do të mund ta ngrisin zërin kundër padrejtësive ndaj organizatave rinore në Kosovë.

Rrjeti Rinor i Kosovës është rrjeti i pavarur, shumetnik që përfaqëson 124 qendra dhe organizata rinore në tërë Kosovën. Ai synon zhvillimin e kapaciteteve të të rinjve për ti adresuar më mirë nevojat e tyre dhe që të jenë akterë të efektshëm në një shoqëri të lirë, të hapur, demokratike në Kosovë.

*Për më shumë informata, vizitoni [www.kosoyouth.net](http://www.kosoyouth.net)*

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

**Dialog publik shumë palësh****"Të bëjmë qytete më të mira së bashku"**

Më shumë se 200 përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile, dhe publikut nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia u mbledhën në Hotel Grand në Prishtinë për të diskutuar për qeverisjen e mirë urbane.

Ata u takuan nga 27 deri më 28 shtator gjatë një konference dy-ditëshe, iniciativë kjo e përbashkët e Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, UN Habitat-it dhe ATRC-së.

Konferenca u përqendrua në partneritetin për të krijuar qasje strategjike ndaj zhvillimit të planifikimit dhe menaxhimit urban. Ajo ofroi mundësi për qytetarë të Kosovës dhe vendeve të tjera nga Evropa Juglindore që të këmbejnë përvoja dhe shembuj për praktikën e mira ndaj qeverisjes lokale.

Prezantimet dhe diskutimet gjatë konferencës u përqendruan në parimet e qeverisjes së mirë urbane në raport me zhvillimin lokal, shfrytëzimin e hapësirës, përfshirjen publike, angazhimin e shoqërisë civile në vendim-marrje dhe transparenca në proceset e vendim-marrjes.

Pjesëmarrësit janë pajtuar se autoritetet lokale dhe ato qendrore mund ti zbatojnë parimet e qeverisjes së mirë për ushtrim më të efektshëm të pushtetit të tyre në të mirë të qytetarëve.

**Rregulloret e tanishme për TVSH dhe taksat doganore pengojnë ndihmat humanitare në Kosovë, thonë OJQ-të**

Përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, institucioneve qeverisëse dhe agjencive ndërkombëtare diskutuan për arsyeshmërinë dhe ndikimin e heqjes së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksave doganore për OJQ-të me status të beneficionit publik gjatë një konference më 5 tetor në Hotel Victory në Prishtinë.

Konferenca është organizuar nga IREX dhe Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim në kuadër të Programit Kosovar për Shoqërinë Civile, në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për të Drejtën e Organizatave Jo për Përfitim (ICNL).

Deri më 1 janar 2006, OJQ-të me status të beneficionit publik kanë qenë të liruara nga tatimi mbi vlerën e shtuar si dhe nga taksat doganore. Rregulloret e tanishme për TVSH dhe taksat doganore kanë rivendosur taksa për OJQ-të me status të beneficionit publik. Përfaqësues të këtyre OJQ-ve kërkuar heqjen e menjëhershme të këtyre taksave.

"Situata e tanishme ka bllokuar punën e OJQ-ve



*Përfaqësues të OJQ-ve me status të beneficionit publik kërkojnë heqjen e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe taksat doganore më 5 tetor, Prishtinë*

me status të beneficionit publik dhe ka pakësuar ndihmën humanitare për komunitetet e varfra në Kosovë", ka thënë Zef Shala, kryetar i Shoqatës Nëna Terezë. Sipas Shalës, statusi i beneficionit publik nuk vlen më për OJQ-të në Kosovë.

Artur Krasniqi, përfaqësues i organizatës "Shtëpia e Shpresës", ka shtuar se "gjendja aktuale pengon aktivitetet humanitare për OJQ-të dhe se kjo nuk është e drejtë".

Përfaqësues nga Shtylla e IV-të e UNMIK-ut, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe Administratës Tatimore argumentuan

se faza e emergjencës ka përfunduar dhe taksimi do të kontribuonte Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

OJQ-të reagues duke shtuar se taksimi i OJQ-ve me status të beneficionit publik do të kishte më shumë pasoja negative sesa përfitime pozitive për popullsinë e Kosovës. Rregulloret e tanishme për TVSH dhe taksa doganore ndalojnë ndihmat humanitare për shumë të varfër, deklaruan ata duke iu referuar statistikave të Bankës Botërore që tregojnë se 15% e kosovarëve jetojnë në varfëri të skajshme.

Edgargo Ruggiero, drejtor i Fondit Monetar Ndërkombëtar, veçoi rëndësinë e vendosjes së një sistemi që do të mundësonte punën e OJQ-ve me status të beneficionit publik dhe po ashtu do të parandalonte mundësitë për keqpërdorim.

Pjesëmarrësit e konferencës konkluduan se populli i Kosovës është ai që pëson nga ligjet aktuale ve jo organizatat joqeveritare dhe se dialogu për të zgjidhur këtë çështje duhet të vazhdoj.

*OJQ-të me status të beneficionit publik përfshirë Shoqatën Nëna Terezë, Team Kosova, Shtëpia e Shpresës dhe Gjymnazi Loyola mbajtën konferencë për media më 15 tetor për të informuar publikun për ndikimin që kanë TVSH-ja dhe taksat doganore në punën e tyre. Ata kërkuar heqjen e këtyre taksave për OJQ-të me status të beneficionit publik.*



## Flesh Lajme për OJQ

**Agjencioni Antikorrupsion të parandaloj përhapjen e korrupsionit në Kosovë**



ATRC-ja ka organizuar më 22 shtator tryezë të rumbullakët ndërmjet Hasan Preteni, drejtor i Agjencionit Antikorrupsion dhe OJQ-ve vendore.

Preteni i njoftoi përfaqësuesit e OJQ-ve për punën dhe aktivitetet e ardhshme të këtij agjencioni dhe diskutoi për rolin dhe kontributin e shoqërisë civile në luftimin e korrupsionit në Kosovë.

"Agjencioni Antikorrupsion nuk e zgjidh çështjen e korrupsionit", ka thënë Preteni. "Ai është shërbim të cilin qytetarët mund ta shfrytëzojnë për ta luftuar këtë fenomen. Prandaj agjencioni është transparent dhe i hapur për bashkëpunim". Pjesëmarrësit kërkuan nga agjencioni që punën e vet ta përqendroj në parandalimin e përhapjes së korrupsionit në Kosovë.

### Të rinj nga Kosova dhe Serbia diskutojnë për të ardhmen

Të rinj nga Kosova dhe Serbia debatuan për marrëdhëniet në të ardhmen gjatë një diskutimi publik të organizuar nga Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut më 3 nëntor në ATRC.

Ata shprehën mendime të njëjta për marrëdhëniet bilaterale në të ardhmen dhe u pajtuan se pa marrë parasysh statusin e ardhshëm politik të Kosovës, këto dy vende duhet të kenë marrëdhënie të mira fqinjësore, gjë që do ti kontribuonte stabilitetit në rajon. *Për më shumë informata kontaktoni: ksoffice@yihhr.org.*

### Mundësi financimi për OJQ-të

## SEKTOR Programi i REC-it përkrah organizatat e shoqërisë civile për ambient në Evropën Juglindore



Merita Fazliu Mehmed, menaxhere e projektit në Qendrën Rajonale të Mjedisit

(REC) Zyra në Kosovë, informoi përfaqësuesit e OJQ-ve vendore për shpalljen e granteve kombëtare dhe rajonale në kuadër të SEKTOR Programit, gjatë një takimi të organizuar nga ATRC-ja dhe REC-i më 11 tetor. Ajo prezantoi objektivat e financimit të REC-it, prioritetet, procedurat e aplikimit dhe afatin e granteve. Ajo po ashtu u përgjigj në pyetjet e përfaqësuesve të OJQ-ve.


"SEKTOR grant programi ka për qëllim tu mundësoj

akterëve të shoqërisë civile që të adresojnë çështje të mjedisit urban dhe zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor në Evropën Juglindore", ka pohuar Mehmed. "Përkrahja duhet të rezultojë në forcimin e shoqërisë civile për të ngritur vetëdijen e komunitetit për kushtet dhe zgjidhjen e mundshme të problemeve në sektorin e mjedisit (posaçërisht çështjeve mjedisore dhe shëndetësisë)", shtoi ajo. Me përkrahjen e REC-it, organizatat duhet të promovojnë ndryshime nëpërmjet lobimit për mjedis, avokim dhe duke vepruar si vëzhgues të qeverisë dhe industrisë, ka thënë Mehmed.

SEKTOR grant programi i REC-it përkrahët nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

*Për informata më të hollësishme vizitoni: <http://kos.rec.org>.*

Prezantimi i donatorëve është pjesë e programit të ATRC-së që synon njoftimin e OJQ-ve me mundësi financimi dhe donatorët me OJQ-të që kanë interesa të ngjashme.



*Për informata më të hollësishme për SEKTOR Programin e REC-it vizitoni at: <http://kos.rec.org>*

### Prezantim i OJQ-ve lokale

## Iniciativa Kosovare për Stabilitet hulumton të kaluarën e Prishtinës, perspektivat për të ardhmen

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është organizatë e pavarur, jo fitimprurëse, e cila merret me hulumtime socio-ekonomike dhe analizon një sërë fenomenesh socio-ekonomike në Kosovë dhe rajon.

Themeluar në vitin 2004, IKS-i ofron hulumtim inovativ që synon inicimin e debateve për çështje me rëndësi për zhvillimin e së ardhmes së Kosovës. Ajo kombinon metodat hulumtuese të Iniciativës Evropiane për Stabilitet (ESI) me qasje kosovare ndaj



Harta e parë e trashëgimisë kulturore të Prishtinës

hulumtimit.

Aktualisht, IKS-i në partneritet me ESI-në po e shpalos tregimin për Prishtinën: zhvillimin e saj socio-ekonomik gjatë së kaluarës së afërt dhe perspektivat për të ardhmen.

Në kuadër të këtij projekti, këtë vit IKS-i ka publikuar një hulumtim për Trashëgiminë Kulturore të Prishtinës, të cilin mund ta lexoni në [www.iksweb.org](http://www.iksweb.org)

*Për më shumë informata vizitoni këtë web faqe ose kontaktoni: [info@iksweb.org](mailto:info@iksweb.org)*

**atrc****Executive Director**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org**Financial & Administration  
Manager**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org**Grant Manager**  
TEUTA LUXHA  
teuta@advocacy-center.org**Grant Officer**  
KUSHTRIM KALOSHI  
kushtrimk@advocacy-center.org**Grant Officer**  
XHAFAH AHMETI  
kushtrimk@advocacy-center.org**Training & Consultancy  
Services Manager**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
NORA SUSURI  
nora@advocacy-center.org**Communication & Outreach  
Manager**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org**Program Officer**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org**IT and Database Manager**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.orgRr. Agim Ramadani Nr. 15  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë  
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810**Publikime të reja****"Ne dhe Trupi Ynë -  
në Shekullin e ri"  
Një libër i shkruar  
nga gratë për gratë**


"Ne dhe Trupi Ynë - në Shekullin e ri" tashmë i ofrohet edhe grave kosovare iniciuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (KGSC).

"Ky libër njihet si bibla për shëndetin e grave", ka thënë Luljeta Vuniqi, drejtoreshë e KGSC-së gjatë prezantimit publik të librit më 22 shtator në ATRC.

Publikuar për herë të parë më 1984 nga Qendra për Shëndetin e Grave në Boston, SHBA, "Ne dhe Trupi Ynë" është i shkruar nga gratë për gratë. Që atëherë, 4 milion kopje të librit janë shitur në mbarë botë.

"Libri shërben si udhërrëfyes për shëndetin e grave, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, racore, fetare ose gjeografike", ka shtuar Vuniqi.

Iniciativa për të publikuar këtë libër në Kosovë është financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe përkrahur nga UNDP, UNIFEM, UNICEF dhe UNFPA.



Për më shumë informata kontaktoni: [info@kgscen-ter.org](mailto:info@kgscen-ter.org).

**Avokimi për të  
Drejtat e  
Minoriteteve në BE:  
Një udhëzues për OJQ-të  
në Evropën Juglindore**

Ky udhëzues unik për avokim mbi të drejtat e minoriteteve në Bashkimin Evropian synon tu jap mundësi aktivistëve të të drejtave të minoriteteve dhe njeriut nga Evropa Juglindore (SEE) që të avokojnë suksesshëm për përfshirje të çështjeve të minoriteteve në procesin e anëtarësimit të vendeve të tyre në BE dhe për përmirësimin e të drejtave të minoriteteve.


Ky është publikimi i OJQ-së "Grupi Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve" ([www.minorityrights.org](http://www.minorityrights.org)) dhe adreson çështje qenësore për kuptim të plotë të mundësive për avokim mbi të drejtat e minoriteteve brenda BE-së, përfshirë çështjet janë të aplikueshme sapo që shtetet e SEE-së të anëtarësohen në BE. Kapitulli i parë prezanton BE-në, zhvillimin e saj nga një asociacion ekonomik në një union politik, strukturën e saj institucionale dhe proceset vendim-marrëse.

Kapitulli i dytë shqyrton politikën e BE-së ndaj rajonit dhe natyrën e zgjerimit të saj nga menaxhimi i konfliktit, ndihma për rindërtim dhe zhvillim, deri te procesi i zgjerimit. Kapitulli i tretë përshkruan standardet e BE-së për mbrojtjen e minoriteteve në kontekstin e zgjerimit, sikurse edhe instrumentet dhe mekanizmat për mbrojtjen e minoriteteve për vendet anëtare. Ky artikull është marrë nga *Balkan Academic News*. Teksti i plotë përshkruar gjendet në: [http://www.minorityrights.org/admin/Download/pdf/MRG\\_EUGuide.pdf](http://www.minorityrights.org/admin/Download/pdf/MRG_EUGuide.pdf).

**Shoqëria civile  
dhe qeverisja e  
mirë në shoqëritë  
në tranzicion**

*Cili është ndikimi i shoqërisë civile për qeverisje të mirë në shoqëritë në tranzicion?*

*Një libër i ri synon të gjej përgjigjet.*



Në këtë përmbledhje, studiues dhe praktikantë nga shtatë vende të Evropës Juglindore përshkruajnë rolin e shoqërisë civile dhe qartësojnë marrëdhëniet e saj në promovimin e qeverisjes së mirë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe Slloveni.

Duke përshkruar sfidat e së kaluarës dhe perspektivat për të ardhmen e shoqërisë civile, kontribuuesit reflektojnë për çështje siç janë korniza ligjore për OJQ-të, gjendja e tyre financuese dhe institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverive dhe shoqërisë civile. Libri konkludon se shoqëria civile luan rol esencial për zhvillim të shoqërisë dhe zbatim të ligjit, posaçërisht në situata post-konfliktuale. Qeveritë nxiten që të mbështesin këtë potencial të shoqërisë civile. Ky artikull është marrë nga *Balkan Academic News*. Për më shumë informata kontaktoni: [office@nww.at](mailto:office@nww.at) ose vizitoni [www.nww.at](http://www.nww.at)